



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË DEÇANIT PËR VITIN 2021

Prishtinë, maj 2022

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Deçanit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Deçanit (KD), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Deçanit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- A1 Realizimi i të hyrave në PFV ishte nënvlerësuar për 4,433€. Po ashtu, ishte bërë prezantim jo i saktë për të hyrat jo tatimore të cilat ishin nënvlerësuar për 143,904€ si dhe raportin për të hyrat vetanake të pa shpenzuara të cilat ishin nënvlerësuar për 142,657€;
- B1 Shpalosjet e pasurive në PFV nuk ishin të plota dhe të sakta ngase ishin nënvlerësuar për 4,133,897€ si dhe për katër (4) mostra prej 99,710€, nuk kemi mundur të testojmë ekzistencën e tyre ngase komuna nuk ishte në gjendje të ofronte dëshmitë burimore;
- B2 Shpalosjet e detyrimeve kontigjente nuk ishin të plota dhe të sakta ngase ishin nënvlerësuar për 1,260,823€.
- B3 Si pasojë e pagesave të ekzekutuara nga Thesari në bazë të vendimeve gjyqësore/përmbarrimore, komuna ka paguar dhe regjistruar shpenzime nga kategoritë ekonomike jo adekuate në vlerë 62,203€.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, për shkak të rëndësisë së çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të Komunës së Deçanit nuk kanë qenë në përputhje me:

Baza për konkluzion

- B4 Mangësi në menaxhimin e të hyrave nga tatimi në pronë;
- B5 Te kontratat kornizë "Mirëmbajtje verore dhe dimërore në rrugët e komunës së Deçanit" ka pasur tejkallim të sasisë së kontraktuar në vlerë 373,947€, përkatësisht te kontrata "Furnizim me material zyrtar për institucionet publike në Komunën e Deçanit", ka pasur tejkallim të sasisë së kontraktuar në vlerë 3,625€;
- B6 Mangësi në emërimin dhe angazhimin e zyrtarëve për kryerjen e shërbimeve të veçanta;
- B7 Komuna gjatë vitit 2021 kishte kryer pagesa në vlerë prej 1,671,047€ apo 1,317 raste të pagesave të cilat e kanë tejkalluar afatin ligjor;
- B8 Mangësi në shpërndarjen e subvencioneve për organizatat jo qeveritare - OJQ; dhe
- B9 Mos inspektimi i gjendjes aktuale të objekteve brenda territorit të komunës.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Deçanit.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Deçanit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Deçanit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Deçanit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticism profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Deçanit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.

- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Procesi i raportimit në komunë ishte përcëlluar me mangësi, kjo ishte vërejtur edhe me rastin e përgatitjes së PFV-ve. Pas kërkesës sonë, pasqyrat janë korrigjuar dhe dorëzuar në ZKA dhe disa nga çështjet e ngritura nga ne janë korrigjuar. Mirëpo, gjatë procesit të auditimit kemi evidentuar mangësi në shpalosjen e pasurive, detyrimeve kontingjente, klasifikimin e shpenzimeve, të dhënat për realizimin e të hyrave me fokus në shënimet për të hyrat jo tatimore si dhe raportin për të hyrat vetanake të pa shpenzuara. Gjetjet dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me 15 rekomandime, prej tyre tre (3) janë rekomandime të reja si dhe 12 të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja A1 - Mangësi në shpalosjen e informatave në PFV

Gjetja

Rregullorja Nr. 01/2017 për Pasqyrat financiare vjetore të organizatave buxhetore ndër të tjera përcakton detyrimet e raportimit, mënyrën e raportimit dhe formën e raportimit të organizatave buxhetore. Ndërsa neni 21 thotë se: Organizatat buxhetore raportojnë shumën e të hyrave vetanake të bartura nga viti paraprak, pranimit gjatë vitit fiskal që kanë qenë në dispozicion për shpenzime gjatë periudhës së raportimit si dhe bilancin e pa shpenzuar në fund të periudhës raportuese.

Procesi i përgatitjes së PFV-ve ishte shoqëruar me disa mangësi të cilat kanë rezultuar në vlera të cilat nuk janë paraqitur sipas të dhënave në SIMFK, dhe të cilat janë trajtuar si në vijim:

- Te neni 14 Raporti i ekzekutimit të buxhetit/Hyrja parasë së gatshme, realizimi i të hyrave ishte nënvlerësuar për 4,433€, ngase në PFV janë paraqitur 736,061€ përderisa në SIMFK janë 740,494€ (duke përfshirë këtu edhe donacionet prej 28,118€). Kjo ishte për shkak se nuk janë paraqitur të hyrat nga viti i kaluar (kodi ekonomik 61000) të cilat në SIMFK janë në vlerë 1,249€ si dhe të hyrat jo tatimore ishin nënvlerësuar për 3,182€.
- Shënimi 9 për Të hyrat jo tatimore, realizimi i tyre është paraqitur 382,028€ përderisa në SIMFK është 238,124€, duke rezultuar me mbivlerësim prej 143,904€. Kjo ishte për shkak se komuna këtu ka përfshirë edhe të hyrat indirekte të mbledhura nga institucionet tjera në emër të komunës. Përderisa këto nuk është dashur të përfshihen në totalin e të hyrave jo tatimore, por vetëm të shpalosen poshtë

tabelës.

- Te neni 21 për Raportin e të hyrave vetanake të pa shpenzuara, shuma e të hyrave të pranuar për vitin 2021 është paraqitur 855,032€ përderisa në SIMFK është 712,376€, rrjedhimisht kjo ka ndikuar edhe në mbivlerësimin e të hyrave për bartje në vitin 2022 e cila ishte paraqitur 324,434€ përderisa sipas të dhënave në SIMFK është 181,777€. Sipas arsytimit që është dhënë në PFV, vlera 855,032€ përfshinë edhe të hyrat prej 143,905€ të cilat janë arkëtuar në vitin 2021 si tejkalim i planifikimit buxhetor por që nuk kanë mundur të bëjnë azhurnimin e të dhënave në SIMFK pa procedurën e aprovimit të tyre në Kuvendin Komunal.

Kjo gjendje ishte për shkak të mosfunksionimit të kontrolleve gjatë procesit të përgatitjes së PFV-ve.

Ndikimi

Shpalosja e pa saktë e të dhënave për të hyrat ka ndikuar në nënvlerësimin/mbivlerësimin e tyre dhe mund të shpie në keqkuptimin e aktiviteteve financiare të komunës, Rrjedhimisht kjo, së bashku me gabimet tjera ka ndikuar në kualifikimin e opinionit të auditimit.

Rekomandimi A1

Kryetari, duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprime për t'i adresuar shkaqet që kanë ndikuar në kualifikimin e opinionit të auditimit, për të siguruar se informatat lidhur me të hyrat janë të plota dhe të sakta në PFV.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B1 - Mangësi në regjistrat e pasurive kapitale dhe jo kapitale

Gjetja

Neni 6.1 i Rregullores Nr. 02/2013 për Menaxhimin e pasurive jo financiare kërkon që: “çdo organizatë buxhetore duhet të krijojë dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që i ka në menaxhimin e saj. Po ashtu, sipas nenit 6.3: Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin e-pasuria”.

Kemi evidentuar se komuna nuk kishte bërë regjistrimin e pasurive të blera gjatë vitit 2020 dhe 2021. Rrjedhimisht, regjistri i pasurive kapitale mbi 1,000€ ishte nënvlerësuar për 3,920,739€ pasi që pagesat e shpenzimeve kapitale (ndërtim i rrugëve, shpronësime, mirëmbajtje investive etj.) nuk ishin regjistruar në SIMFK. Pasuria jo kapitale nën 1,000€ ishte nënvlerësuar për 213,158€, pasi që blerjet e mallrave, mobileve dhe pajisjeve të ndryshme nuk ishin regjistruar në E-pasuria. Ndërsa për katër (4) mostra të përzgjedhura nga regjistri i pasurive me bazë nga vitet paraprake në vlerë prej 99,710€, nuk kemi mundur të testojmë ekzistencën e tyre ngase komuna nuk ishte në gjendje të na ofronte dëshmitë burimore. Po ashtu, çështjet e ngritura në raportin e vitit të kaluar janë bartur edhe në vitin 2021, përkatësisht:

- 22 vetura të llojeve të ndryshme të cilat janë të vjetra dhe vlera e tyre në libra do duhej të ishte zero, nuk janë zhvlerësuar fare duke mbivlerësuar pasurinë kapitale neto për 70,615€;
- Objekti i shkollës fillore “Edmond Hoxha” nuk i takon Komunës së Deçanit por asaj të Junikut ndërsa ende figuron në regjistrat e pasurisë kapitale duke e mbivlerësuar pasurinë kapitale bruto për 256,660€;
- Pronat e komunës ende nuk janë të vlerësuara dhe të regjistruara në

regjistrat kontabël.

Kjo ka ndodhur për shkak të mos funksionimit të kontrollit të brendshëm me ç' rast informacionet relevante për regjistrimin e drejt të pasurisë nuk qarkullojnë në mënyrë të ndërsjellë në mes të departamentit të financave dhe zyrtarit të pasurisë. Përderisa sipas arsytimit të komunës, kjo gjendje ishte për shkak të ndikimit të pandemisë Covid 19 si dhe daljes në pension të zyrtarit të pasurive dhe pa mundësisë së zhvillimit të procedurave të rekrutimit për mbulimin e kësaj pozite.

Ndikimi

Mungesa e regjistrave të saktë dhe të plotë shkakton mungesë të informatave për menaxhmentin lidhur me pasurinë që posedon komuna, shkakton mbi/nënvlerësim të pasurive si dhe mund të rezultojë në prezantimin jo të drejtë të informatave në pasqyra financiare.

Rekomandimi B1

Kryetari duhet të sigurojë funksionimin e kontrollit të brendshëm në mirëmbajtjen e regjistrave të pasurisë duke vendosur komunikimin ndërmjet zyrtarit të pasurisë në njërin anë dhe departamentit të financave në anën tjetër për të siguruar se të gjitha pasuritë e komunës janë identifikuar dhe regjistruar saktë në regjistrat përkatës të pasurive komunale.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Nënvlerësimi i detyrimeve kontigjente

Gjetja

Neni 18 i Rregullores 01/2017 për Pasqyrat financiare vjetore të organizatave buxhetore thotë se: "Organizatave buxhetore në harmoni LMFPP-në raportojnë të gjitha detyrimet kontigjente".

Shpalosjet e detyrimeve kontigjente nuk ishin të plota dhe të sakta ngase ishin nënvlerësuar për 1,260,823€.

Kjo gjendje ishte për shkak të mungesës së komunikimit të mirëfilltë mes sektorit të financave dhe përfaqësuesit ligjor të komunës, ngase kjo çështje ishte trajtuar edhe në raportin e vitit paraprak. Ndërsa sipas përfaqësuesit ligjor të komunës, kjo gjendje ishte për shkak të angazhimit të madh në seanca gjyqësore.

Ndikimi

Mos shpalosja e plotë e detyrimeve kontigjente ka ndikuar në nënvlerësimin e tyre dhe mund të shpie në keqkuptimin e aktiviteteve financiare të komunës. Rrjedhimisht kjo, së bashku me gabimet tjera ka ndikuar në kualifikimin e opinionit të auditimit.

Rekomandimi B2

Kryetari, duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprime për t'i adresuar shkaqet që kanë ndikuar në nënvlerësimin e detyrimeve kontigjente për të siguruar se shpalosjet e tyre janë të plota dhe të sakta në PFV.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B3 - Keq klasifikim i shpenzimeve**Gjetja**

Udhëzimi administrativ Nr. 19/2009 për planin kontabël, nenit 8.1 dhe 8.3 kanë përcaktuar qëllimin dhe strukturën e planit kontabël, si dhe klasifikimin ekonomik të shpenzimeve të cilat duhen të bëhen sipas kodeve dhe kategorive të caktuara ekonomike.

Komuna ka paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë 62,203€ nga kategoritë ekonomike jo adekuate. Këto pagesa janë kryer nga Thesari në bazë të vendimeve gjyqësore/përmbartimore dhe kanë të bëjnë me kompensimin e pagave jubilarë dhe përcjellëse me rastin e pensionimit të punonjësve si dhe me borxhet ndaj furnitorëve të ndryshëm. Përkatësisht:

- Nga subvencionet ishin paguar 28,990€ për investime kapitale lidhur me borxhet ndaj furnitorëve;
- Nga mallrat dhe shërbimet ishin paguar 18,050€ për investime kapitale lidhur me borxhet ndaj furnitorëve;
- Nga investimet kapitale ishin paguar 11,150€ për paga jubilarë dhe të pensionimit që kanë buruar nga obligimet e kontratave kolektive. Po ashtu, nga investimet kapitale ishin paguar edhe 4,013€ për mallra dhe shërbime lidhur me borxhet ndaj furnitorëve.

Këto kanë ndodhur për shkak të planifikimit të dobët të buxhetit nga ana e komunës dhe mos aprovimit të kërkesave buxhetore të komunës nga MF.

Ndikimi

Keq klasifikimi i shpenzimeve rezulton me pasqyrimin jo të drejtë të shpenzimeve në PFV, rrjedhimisht mund të shpie në keqkuptim të aktiviteteve financiare të komunës.

Rekomandimi B3

Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit (apo të ridestinohen mjetet kur është e nevojshme dhe e mundshme) dhe që pagesa e regjistrimi i shpenzimeve bëhet në mënyrë strikte sipas kodeve ekonomike adekuate.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja B4 - Mangësi në menaxhimin e të hyrave nga tatimi në pronë

Gjetja Ligji nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 11.1 përcakton se, personi fizik i cili vendos se njësia e objektit shërben si vendbanim parësor (për të cilën e deklaron në Komunë), i lejohe zbritja prej 15,000€ nga vlera e vlerësuar e njësisë së objektit. Përveç kësaj, Ministria e Financave përkatësisht Departamenti i Tatimit në Pronë, ka njoftuar komunat për vendimin e marrë për regjistrimin e numrit personal në rastin e zbatimit të nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-005, me qëllim të shmangies së dyfishimeve/ apo parregullsive dhe sigurimin e zbatimit efektiv të këtij neni.

Pas analizës së bërë, në lidhje me zbatimin e zbritjes së lejuar për vendbanimin parësor dhe zbatimit të Vendimit për regjistrimin e numrit personal, janë identifikuar mangësitë si në vijim:

- Për 844 tatimpagues, është zbatuar zbritja prej 15,000€ nga vlera e vlerësuar e njësisë së objektit, duke u mbështetur në nenin 11 - “Zbritjet për vendbanim parësor”, mirëpo kjo zbritje është bërë për pronat e personave për të cilët nuk ishte evidentuar numri personal, ku për pasojë rezulton më pak të hyra nga tatimi në pronë për rreth 18,990€.
- Për më tepër, në kuadër të 844 tatimpaguesve tek të cilët është zbatuar zbritja prej 15,000€ nga vlera e vlerësuar e njësisë së objektit, janë 171 tatimpagues për të cilët nuk ishte përcaktuar kategoria e pronës.

Sipas konfirmimeve zyrtare, kjo çështje ishte bartur nga vitet paraprake, mirëpo për faturimet e vitit 2022, për tatimpaguesit që nuk kanë numër personal të evidentuar dhe të cilët nuk e kanë deklaruar “Banimin Parësor” nuk do të zbatohet zbritja e lejuar.

Ndikimi Zbatimi i zbritjeve të lejuara për tatimpaguesit pa numër personal dhe pa u deklaruar se vendbanimi i tatimpaguesit shërben si vendbanim parësor, mund të rezultojë me përllogaritje të pasakta të zbritjeve për tatimin në pronë dhe rrjedhimisht më pak të hyra.

Rekomandimi B4 Kryetari i Komunës të sigurojë, bashkëpunim dhe komunikim më të mirë ndërmjet Sektorit Komunal të Tatimit në Pronë dhe Ministrisë së Financave, në mënyrë që të eliminohen gabimet e mundshme në të dhënat për tatimin e vlerësuar.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B5 - Mospërputhje ndërmjet situacionit të punëve të kryera dhe specifikacionit të kontratës**Gjetja**

Sipas Udhëzuesit për prokurimin publik, pika 56 Kontrata Kornizë pika 10- Sasia e parashikuar e specifikuar në dokumentet e tenderit është vetëm sasi indikative. Kurdo që Autoriteti kontraktues specifikon sasinë indikative, Autoriteti kontraktues do të specifikojë në dosjen e tenderit vlerën ose sasinë e kontratës si një prag apo një tavan dhe do të lejojë devijimin prej tij, duke deklaruar gjithashtu përqindjen e mospërputhjes së lejuar. Mospërputhja e lejuar nuk mund të jetë më e lartë se plus/minus tridhjetë përqindje (30%). Nëse urdhër blerjet tejkalojnë sasinë totale indikative ose vlerën totale indikative të kontratës publike kornizë (duke përfshirë + 30%, pa marrë parasysh datën origjinale të skadimit të Kontratës Publike Kornizë, kontrata do të ndërpritet automatikisht. Mospërputhja e lejuar plus/minus tridhjetë përqind (30%) vlen edhe për Lote dhe për pozicion/artikull, dhe në rast të arritjes së pragut të lejuar AK nuk mund të bëjë porosi tjera për atë Lot apo pozicion/artikull.

Nga testimi i pagesave të kontratës publike kornizë "Mirëmbajtja verore dhe dimërore në rrugët e komunës së Deçanit" kemi vërejtur tejkallim të sasisë së kontraktuar dhe asaj të faturuar/paguar. Tejkallim të sasive kishte në katër (4) pozicione në vlerë totale prej 373,947€:

- Te pozicioni nr. 4 sasia e kontraktuar ishte 15,000m³ plus 30% tejkallimi i lejuar, gjithsej sasia e lejuar ishte 19,500m³, ndërsa sasia e realizuar ishte 49,915m³. Pra kishte tejkallim për 30,415m³ apo 106,454€;
- Te pozicioni nr. 5 sasia e kontraktuar ishte 30,000m² plus 30% tejkallimi i lejuar, gjithsej sasia e lejuar ishte 39,000m², ndërsa sasia e realizuar ishte 77,887m². Pra kishte tejkallim për 38,887m² apo 31,110€;
- Te pozicioni nr. 6 sasia e kontraktuar ishte 8,500m³ plus 30% tejkallimi i lejuar, gjithsej sasia e lejuar ishte 11,050m³, ndërsa sasia e realizuar ishte 44,349m³. Pra kishte tejkallim për 33,299m³ apo 233,093€;
- Te pozicioni nr. 5 (i pjesës së dytë të paramasës) sasia e kontraktuar ishte 6km plus 30% tejkallimi i lejuar, gjithsej sasia e lejuar ishte 7.8km, ndërsa sasia e realizuar ishte 12.5km. Pra kishte tejkallim për 4.7km apo 3,290€.

Po ashtu, te kontrata "Furnizim me material zyrtar për institucionet publike në Komunën e Deçanit", nuk ishte respektuar kriteri +/- 30% për realizimin e sasive nëpër pozicione. Tejkallim të sasive kishte në tre (3) pozicione në vlerë totale prej 3,625€. Përkatësisht, te pozicioni 119, tejkallimi ishte në vlerë 1,575€, te pozicioni 121, tejkallimi ishte 1,350€ si dhe te pozicioni 175, tejkallimi ishte 700€.

Sipas zyrtarëve komunal përkatësisht menaxherit të kontratës sasitë e tejkaluara te kontrata "Mirëmbajtja verore dhe dimërore në rrugët e komunës së Deçanit" janë bërë me aprovimin e kryetarit të komunës. Aprovimi i sasive të tejkaluara është bërë në bazë të punimeve të kryera në një rrugë jashtë qytetit të Deçanit duke arsyetuar se rregullimi i asaj rrugë është prioritet i vet kryetarit dhe kërkesë e banorëve të komunës.

Ndikimi

Mospërputhshmëria ndërmjet situacioneve të punëve/furnizimeve të

realizuara dhe specifikacionit të kontratës krijon paqartësi lidhur me nevojat reale për punë dhe ndikon në zbatimin e drejtë të kontratës sipas kushteve kontraktuale dhe kornizës ligjore të prokurimit publik.

Rekomandimi B5 Kryetari duhet të sigurojë përmirësimin e kontrolleve të brendshme lidhur me planifikimin e saktë të nevojave për punë dhe zbatimin e drejtë të kornizës ligjore të prokurimit publik. Po ashtu duhet të sigurojë se projektet e specifikuara nuk tejkalojnë paramasën e përlllogaritur si në sasi ashtu edhe në vlerë ashtu siç janë përcaktuar me kushtet e kontratës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B6 - Angazhimi i zyrtarëve për kryerjen e shërbimeve të veçanta pa procedura

Gjetja UA Nr. 01/2018 neni 7, Ligji i punës 03/L-212 neni 10 paragrafi 6 Kontrata për një detyrë specifike, nuk mund të jetë më e gjatë (120) ditë brenda një (1) viti, Ligji për Zyratet Publik Nr.06/L-114 neni 84 Marrëveshjet për shërbime të veçanta, sipas paragrafit 4 të nenit 12 të Ligjit të Shërbimit Civil nr. 03/L-149 të Republikës së Kosovës, të lidhura para hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë të vlefshme deri në afatin e përcaktuar në ato marrëveshje në pajtim me dispozitat e lartcekura. Pas kësaj periudhe, marrëveshjet për shërbimet e veçanta lidhen sipas legjislacionit përkatës të prokurimit publik.

Komuna e Deçanit gjatë vitit 2021 me vendime të kryetarit për emërim dhe sipas Marrëveshjeve për shërbime të veçanta (MShV), kishte angazhuar 116 punonjës në pozita të rregullta, prej tyre 72 në administratën komunale, 28 në shëndetësi si dhe 16 në arsim. Kohëzgjatja dhe angazhimi i këtyre zyrtarëve ishte lidhur me mandatin e kryetarit pa bazë të qartë ligjore si dhe për një periudhë gjashtë mujore dhe vjetore.

Angazhimet me vendime të kryetarit dhe sipas MShV-ve ishin bërë pa zhvilluar ndonjë procedurë të paraparë ligjore.

Sipas zyrtarëve komunal angazhimi i stafit pa procedura ka ndodhur për shkak të pamundësisë së zhvillimit të procedurave të rekrutimit si dhe nevojave për menaxhimin e pandemisë COVID-19.

Ndikimi Emërimi i zyrtarëve në pozita të rregullta për periudhë të caktuar dhe angazhimi me kontrata për një detyrë specifike me afat më të gjatë sesa parashihet si dhe këshilltarëve pa procedura është në kundërshtim më legjislacionin përkatës dhe njëherësh rritë rrezikun e angazhimit të stafit jo kompetent për pozita të caktuara.

Rekomandimi B6 Kryetari duhet të sigurojë aplikimin e procedurave të prokurimit për angazhimin e stafit për MSHV. Si dhe, të sigurojë se kjo formë e angazhimit aplikohet vetëm për punë specifike dhe vetëm atëherë kur kërkesat janë të arsyeshme nga njësit kërkuese.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B7 - Vonesa në pagesën e faturave dhe shpenzime të larta procedurale të pagesave të ekzekutuara nga Thesari

Gjetja Sipas nenit 39.1 të ligjit Nr.03/L-048 për MFPP, Çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendrike pas pranimit të faturës. Ndërsa, sipas nenit 40, fatura mund të ekzekutohet direkt nga Thesari pas marrjes së urdhrat të prerë nga gjykata/përmbaruesi.

Nga analiza e data bazës së furnitorëve kemi vërejtur se komuna gjatë vitit 2021 kishte kryer pagesa në vlerë prej 1,671,047€ apo 1,317 raste të pagesave të cilat e kanë tejkaluar afatin ligjor. Vonesat variojnë nga 1 deri në 957 ditë.

Po ashtu, në bazë të vendimeve gjyqësore, Thesari kishte ekzekutuar pagesa në vlerë prej 978,783€. Kjo formë e pagesave, përveç ndikimit në keq klasifikimin e shpenzimeve, ka ndikuar edhe në rritjen e shpenzimeve, ngase borxhi kryesor ndaj pretenduesve ishte 856,824€ ndërsa shpenzimet tjera procedurale ishin 121,959€.

Hyrja në obligime pa buxhet dhe neglizhenca e zyrtarëve përgjegjës ka ndikuar në mos realizimin e pagesave brenda afatit kohorë ligjor dhe njëherit realizimin e pagesave me vendime gjyqësore/përmbarimore.

Ndikimi Si pasojë e vonesave të pagesave dhe mungesës së informacioneve të plota, mund të dobësohet aftësia e komunës për të parashikuar dhe menaxhuar nevojat për likuiditet. Situata e krijuar që pagesat të ekzekutohen direkt nga ana e Thesarit përmes procedurave të përmbarimit ka ndikuar në rritjen e kostos për komunën.

Rekomandimi B7 Kryetari duhet të sigurojë që obligimet të planifikohen/buxhetohen dhe paguhen brenda afateve kohore ligjore me qëllim që mos të dëmtohet buxheti i komunës me kosto shtesë të përmbarimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja B8 - Mangësi në shpërndarjen e subvencioneve për organizatat jo qeveritare**

Gjetja Rregullorja Nr. 04/2017, neni 1 përcakton kriteret, standardet dhe procedurat themelore për financimin publik të organizatave jo-qeveritare (këtu e tutje OJQ), me qëllim të vendosjes së një sistemi transparent dhe llogaridhënës për financimin me fonde publike të programeve dhe projekteve të OJQ-ve që janë të interesit publik në Republikën e Kosovës. Po ashtu sipas nenit 12, çdo mbështetje financiare për OJQ-të duhet të shpallet me thirrje publike, e cila duhet të publikohet në ueb faqen e ofruesit të mbështetjes financiare dhe formave tjera për njoftim të OJQ-ve me qëllim të rritjes së konkurrueshmërisë.

Nga testimi i subvencioneve për financimin e projekteve të OJQ-ve në fushën e kulturës, kemi identifikuar se nuk aplikohen procedurat e thirrjes publike për përzgjedhjen e përfutuesve. Përkatësisht, gjatë vitit 2021, komuna kishte subvencionuar pa thirrje publike dhjetë (10) OJQ në vlerë prej 52,070€. Për më tepër, sipas nenit 22 dhe 23 të rregullores 04/2017,

komuna nuk kishte lidhur marrëveshje me përfituesit e subvencioneve ku do të cekej mënyra e shfrytëzimit të mjeteve, raportimi dhe monitorimi i tyre.

Kjo ka ndodhur për shkak të funksionimit jo të mirë të kontrolleve të brendshme.

Ndikimi Ndarja e subvencioneve pa thirrje publike ndikon në transparencë dhe në uljen e konkurrencës, po ashtu mos nënshkrimi i marrëveshjeve/kontratave me përfituesit e subvencioneve rritë rrezikun që mjetet buxhetore të ndahen dhe shpenzohen në kundërshtim me objektivat e Komunës.

Rekomandimi B8 Kryetari duhet të sigurojë që subvencionimi i OJQ-ve bëhet përmes thirrjes publike siç përcaktohet me rregulloren mbi Kriteret Standardet dhe Procedurat e Financimit publik të OJQ-ve. Po ashtu, me rastin e ndarjes së subvencioneve të lidhë marrëveshje me përfituesit për tu siguruar se mjetet shpenzohen për objektivat e përcaktuara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B9 - Mos verifikimi i gjendjes aktuale të objekteve

Gjetja Sipas nenin 15 të pikës 2 të Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatimin në pronën e paluajtshme, Komuna çdo vit duhet të kryejë veprime të inspektimit (verifikimit) për të paktën 20% e të gjitha objekteve brenda territorit të Komunës.

Nga 10,366 objekte të evidentuara në bazën e të dhënave, komuna kishte arritur të verifikoj vetëm 88 prej tyre apo rreth 1%.

Sipas zyrtarëve, inspektimi jo i plotë kishte ndodhur për shkak të stafit të pa mjaftueshëm në sektorin e tatimit në pronë si dhe për shkak të ndikimit të pandemisë COVID-19. Megjithatë, përqindja shumë e ulët e inspektimit, tregon se komuna nuk ka ndërmarrë veprime konkrete për përmirësimin e kësaj situate, megjithëse rekomandimi është përsëritur.

Ndikimi Verifikimi jo i plotë i pronave për qëllime të tatimit në pronë, mund të rezultojë me informata jo të plota të pronës së tatuashme aktuale si dhe të ndikoj në vlerësim jo të saktë të të hyrave për tatimin në pronë.

Rekomandimi B9 Kryetari duhet të sigurojë arritjen e verifikimit të 20% të objekteve të paluajtshme në mënyrë që të integrohen të gjitha ndryshimet eventuale në bazën e të dhënave për pronat ekzistuese të komunës. Mbledhja e të hyrave nga ky burim do të ndikoj drejtpërdrejt në realizimin e projekteve që kanë efekt në rritjen e cilësisë së shërbimeve për qytetarët e komunës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga komuna në vitin 2021 ishin 712,376€ apo rreth 10% më shumë se vitin paraprak. Të hyrat kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj. Komuna kishte edhe të hyra të arkëtuara nga institucionet tjera në emër të komunës si në vijim: gjobat në trafik 139,753€ si dhe gjobat nga gjykatat 7,335€.

Çështja B10 - Ankesa të shumta nga qytetarët për vlerësimin e pronave

- Gjetja** Sipas “Ligjit nr. 06/L-005 neni 12, paragrafi 2, çdo komunë është përgjegjëse për administrimin e procesit të tatimit në pronë për pronat e paluajtshme që ndodhen brenda territorit të komunës. Sipas këtij paragrafi ndër përgjegjësitë e Komunës janë si në vijim: regjistron dhe menaxhon të dhënat e tatimit në pronë në regjistrat e tatimit në pronë, bashkëpunon me Ministrinë e Financave për vlerësimin e pronave të paluajtshme. Po ashtu sipas nenit 31 pika 6 “Komuna merr vendim në lidhje me ankesën e dorëzuar brenda gjashtëdhjetë ditëve nga pranimi i ankesës. Komuna mund të zgjasë, deri në tridhjetë ditë kalendarike, afatin për shqyrtimin e ankesës së dorëzuar me një vendim të arsyetuar”.
- Lidhur me këtë kemi identifikuar se nga gjithsej 138 ankesa lidhur me vlerësimin jo të duhur të pronave, vetëm 12 prej tyre janë refuzuar ndërsa pjesa tjetër e ankesave janë pranuar si të bazuara. Kjo tregon për nivelin e lartë të gabimeve në bazën e të dhënave.
- Kjo ka ndodhur për shkak të komunikimit të pa mjaftueshëm ndërmjet komunës dhe Ministrisë së Financave si dhe stafit të limituar në sektorin e Tatimit në pronë.
- Ndikimi** Mos azhurnimin i informatave dhe vlerësimi jo i duhur i pronave në bazën e të dhënave të tatimit në pronë, mund të ndikoj në vështirësi në inkasimin e të hyrave nga tatimi në pronë dhe rritjen e llogarive të arkëtueshme si pasojë e pakënaqësisë dhe ankesave të qytetarëve.
- Rekomandimi B10** Kryetari duhet të sigurojë një koordinim më të mirë ndërmjet komunës dhe departamentit të tatimit në pronë në kuadër të Ministrisë së Financave, me qëllim të përmirësimit të shënimeve në bazën e të dhënave. Po ashtu, Kryetari duhet të shtoj kontrollet që të sigurojë se bëhet vlerësim i saktë i tatimit në pronë për tatimpaguesit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime dhe komunalitë ishte 1,784,710€, prej të cilave ishin shpenzuar 1,774,320€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me shërbime kontraktuese, shërbime komunale, furnizime të ndryshme për zyre, mirëmbajtjen e objekteve dhe pajisjeve etj.

Çështja A2 - Mangësi në ekzekutimin e pagesës

Gjetja	<p>Sipas kontratës, Lista e çmimeve e paraqitur nga operatori me rastin e ofertimit përmban çmimin për njësi me TVSh si dhe çmimin total për pozicion me TVSh.</p> <p>Te pagesa prej 6,779€ sipas kontratës "Mirëmbajtja hixhienike e institucioneve publike në Deçan", kemi evidentuar se vlera e TVSh-së prej 1,034€ ishte ngarkuar dy herë, rrjedhimisht ka rezultuar në mbi pagesë për vlerën e TVSh-së.</p> <p>Kjo gjendje ishte për shkak të dështimit të kontrolleve në menaxhimin e kontratës nga ana e menaxherit si dhe procesin e ekzekutimit të pagesës nga ana e çertifikuesit.</p>
Ndikimi	<p>Ekzekutimi i pagesave në kundërshtim me kushtet e kontraktuara shpërfaq dobësitë në kontrollet e ushtruara nga menaxheri i kontratës dhe zyrtari çertifikues. Kjo mund të rezultojë me dëmtim të buxhetit dhe keqpërdorim të parasë publike.</p>
Rekomandimi A2	<p>Kryetari duhet të marrë të gjitha veprimet e nevojshme që mjetet e paguara më tepër të kthehen në buxhetin e komunës si dhe të forcojë kontrollet në menaxhimin e kontratave dhe ekzekutimit të pagesave për tu siguruar se nuk do të përsëriten rastet e tilla.</p>

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 15,706,409€, pasurive jokapitale është 80,342€ si dhe e stoqeve zero.

Çështja B11 - Mangësi në procesin e inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive jo financiare

Gjetja Neni 19.4.3 i Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare përcakton se çdo fundvit duhet të bëhet krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen e regjistrave të pasurive jo financiare. Ndërsa neni 21 i po kësaj rregulloreje ka përcaktuar kërkesat për vlerësimin e pasurive jo financiare.

Komuna ka kryer procesin e inventarizimit të pasurive jo financiare (ndonëse me vonesa në sektorin e arsimit dhe administratës), mirëpo nuk ishte bërë krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen e pasurive në regjistrat kontabël, siç kërkohet me nenin 19.4.3 të Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare, rrjedhimisht, nuk dihet diferenca mes gjendjes së kontabilitetit dhe inventarizimit. Po ashtu, nuk ishte bërë fare vlerësimi i pasurive jo financiare sipas kërkesave të nenit 21 të Rregullores 02/2013.

Përderisa vlera e stoqeve në PFV ishte zero, kemi identifikuar se në sektorin e shëndetësisë ishte bërë regjistrimi dhe evidentimi i stoqeve në fund të vitit dhe të cilat nuk ishin shpalosur në PFV. Ndërsa nuk kemi informata lidhur me stoqet për sektorin e administratës dhe arsimit ngase nuk ishte kryer fare procesi i evidentimit të tyre në fund të vitit.

Kjo gjendje ishte kryesisht për shkak të mungesës së njohurive lidhur me kërkesat e rregullores për menaxhimin e pasurive si dhe mungesës së udhëzuesve të brendshëm lidhur me procesin e inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive.

Ndikimi Mos krahasimi i rezultateve të inventarizimit me gjendjen e regjistrave të pasurive dhe mos vlerësimi i pasurive, pamundëson marrjen e sigurisë lidhur me saktësinë dhe plotësinë e regjistrave të pasurisë.

Rekomandimi B11 Kryetari, duhet të sigurojë se procesi i inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive do të kryhet sipas kërkesave të Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore, si dhe më pas, të bëhet krahasimi i rezultateve të inventarizimit me gjendjen kontabël të pasurive, duke i sqaruar të gjitha diferencat.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.4 Të arkëtueshmet

Komuna në PFV e vitit 2021 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 2,096,545€. Kjo vlerë përbehet nga llogaritë e arkëtueshme nga tatimi në pronë si dhe qiratë.

Çështja A3 - Menaxhimi jo efektiv i llogarive të arkëtueshme

Gjetja Sipas nenit 26 të Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme 06-L 005, Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10) eurove dhe sipas nenit 27: Nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën nëse ka të këtillë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori.

Komuna nuk kishte menaxhim efektiv në mbledhjen e të arkëtueshmeve pasi që vazhdon rritja e tyre vit pas viti. Krahasuar me vitin paraprak rritja totale e të arkëtueshmeve ishte rreth 514,104€ apo rreth 32%. Pjesa më e madhe e tyre i takon tatimit në pronë për objekte, përkatësisht në vlerë 1,644,523€ apo rreth 78%, tatimit në pronë për parcela 438,834€ rreth 21% si dhe qiratë 13,188€ apo rreth 1%.

Rritja e llogarive të arkëtueshme vit pas viti ishte për shkak të mos marrjes së të gjitha veprimeve të mundshme për arkëtimin e tyre, ndonëse këtu duhet theksuar edhe ndikimin e pandemisë.

Ndikimi Mos aplikimi i mekanizmave të përcaktuar me ligj dhe rregullore përkatëse ndikon në rritje të vazhdueshme të këtyre llogarive, që rezulton me fonde më të pakta për arritjen e synimeve dhe mund të ndikoj edhe tek debitorët e tjerë që të mos paguajnë detyrimet e tyre.

Rekomandimi A3 Kryetari, duhet të shqyrtojë të gjitha veprimet e mundshme për të siguruar efikasitet më të lartë në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.5 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) kishte drejtorin dhe një anëtar. Përveç planit strategjik, NjAB kishte hartuar edhe planin vjetor të punës ku ishin përfshirë gjashtë (6) auditime (një prej tyre sipas kërkesës), të cilat edhe ishin realizuar gjatë vitit 2021. Numri i rekomandimeve të dhëna në raportet e auditimit është 36, prej të cilave të zbatuara ishin 14, në proces ishin 12 dhe 10 të pazbatuara. Auditimet ishin fokusuar në fushën e prokurimit, rishikimin e proceseve të shpenzimeve, inkasimin e llogarive të arkëtueshme, menaxhimin e personelit si dhe menaxhimin e kontratave, përderisa periudha e mbuluar me auditim ishte kryesisht viti 2021. Komiteti i auditimit ishte funksional dhe kishte mbajtur katër (4) takime, ku ishte diskutuar për punën dhe raportet e NjAB-së.

Çështja B12 - Mungesa e planeve të veprimit në adresimin e rekomandimeve të NjAB-së

Gjetja Neni 5.1.1 i Rregullores 01/2019 për themelimin e Njësisë së Auditimit të Brendshëm përcakton që çdo subjekti i sektorit publik me buxhet mbi shtatë (7) milion euro duhet të ketë së paku tre auditorë. Po ashtu, sipas Rregullores 01/2019 për Themelimin dhe zbatimin e auditimit të brendshëm neni 9, pika 7 - Auditorët e brendshëm monitorojnë zbatimin e rekomandimeve në mënyrë sistematike sipas planit të veprimit të miratuar nga udhëheqësi i subjektit të sektorit publik. Gjithashtu sipas nenit 10 pika 1.3 të së njëjtës rregulloreje - Është përgjegjësi e udhëheqësit të subjektit të sektorit publik për auditimin e brendshëm për të siguruar zbatimin e rekomandimeve për të cilat janë pajtuar për auditimin e brendshëm sipas planit të veprimit.

NjAB në Komunën e Deçanit përbëhet nga drejtori dhe një anëtar, e që duhet të ketë së paku tre auditorë.

Në anën tjetër, njësitë e audituara nuk kishin përgatitur plane veprimi për adresimin e rekomandimeve të dhëna në raportet e auditimit të brendshëm. Si rrjedhojë, rekomandimet e AB-së nuk ishin adresuar sa duhet nga menaxhmenti, ku 10 nga 36 rekomandimet e dhëna për vitin 2021 nuk ishin adresuar.

Kjo gjendje ishte për shkak mungesës së buxhetit të ndarë për plotësimin e numrit minimal të auditorëve sipas kërkesave ligjore. Ndërsa mungesa e planeve për adresimin e rekomandimeve të NjAB-së ishte për shkak të neglizhencës dhe mos përgjegjësisë së zyrtarëve përgjegjës të drejtorive përkatëse.

Ndikimi Mos kompletimi i NjAB-së me staf të mjaftueshëm, mund të ndikojë që auditimi i brendshëm mos të mbulojë të gjitha fushat me rrezik. Ndërsa, mungesa e planit të veprimit dhe ndërmarrja e veprimeve të pamjaftueshme nga menaxhmenti në adresimin e rekomandimeve mund të rezultojë me vazhdimin e dobësive të identifikuar, jo efikasitet në sistemin e kontrollit të brendshëm.

Rekomandimi B12 Kryetari, duhet të sigurojë se për pozitat e kërkuara do të bëhen planifikimet buxhetore me kohë dhe se NjAB të plotësohet me staf të mjaftueshëm sipas rregullores për themelimin e NjAB. Po ashtu, duhet të sigurojë përgatitjen e planeve të veprimit nga njësitë e audituara për adresimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm dhe njëherësh të sigurojë zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga NjAB.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁴	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
Burimet e fondeve	9,942,300	10,333,276	9,785,496	9,845,911	8,782,569
Grante Qeveritare - Buxheti	9,296,135	9,511,958	9,098,298	9,090,915	7,926,709
Financimi përmes huamarrjes	0	32,438	32,434	91,161	53,207
Të bartura nga viti i kaluar	0	112,166	112,052	241,946	332,898
Të hyrat vetanake	646,165	646,165	530,712	421,890	461,547
Donacionet vendore	0	30,498	12,000	0	0
Donacionet e jashtme	0	52	0	0	8,208

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 390,976€. Kjo rritje ishte si rezultat i rritjes së grantit të qeverisë për 215,823€, rritjes së të hyrave të bartura nga viti paraprak për 112,166€, rritjes së donacioneve të brendshme për 30,497€, rritjes së financimit nga huamarrja prej 32,438€ si dhe donacioneve të jashtme për 52€.

Në vitin 2021 OB ka shpenzuar 95% të buxhetit final, me një ulje prej 1% në krahasim me vitin 2020.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)


Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	9,942,300	10,333,276	9,785,496	9,845,911	8,782,569
Pagat dhe mëditjet	5,556,738	5,786,572	5,779,575	5,533,458	5,266,809
Mallrat dhe shërbimet	1,582,859	1,628,710	1,619,414	1,562,168	1,156,447
Komunalitë	156,000	156,000	154,906	155,000	155,259
Subvencionet dhe transferet	140,000	174,113	172,625	115,821	89,343
Investimet Kapitale	813,166	2,477,882	2,058,976	2,479,464	2,114,712
Rezervat	1,693,537	110,000	0	0	0

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje ishte rritur për 229,834€. Rritja ishte si rezultat i rishikimit të buxhetit prej 151,983€, vendimit të Qeverisë prej 55,260€ për të mundësuar harmonizimin e ndarjeve buxhetore të kategorisë së pagave dhe shtesave si dhe kategorive tjera të shpenzimeve, rritjes sipas vendimit të Qeverisë nga huamarrja prej 21,838€ si dhe rritjes nga të hyrat e bartura nga viti paraprak prej 753€;
- Buxheti për mallra dhe shërbime ishte rritur për 45,851€. Rritja ishte si rezultat i rishikimit të buxhetit prej 1,280€, nga të hyrat e bartura për 30,053€ si dhe nga donacionet prej 14,518€;
- Buxheti për subvencione ishte rritur për 34,113€. Rritja ishte si rezultat i rishikimit të buxhetit prej 9,000€ si dhe nga të hyrat e bartura nga viti paraprak prej 25,113€; dhe
- Buxheti për investimet kapitale ishte rritur për 1,664,716€. Rritja ishte si rezultat i rishikimit të buxhetit prej 8,900€, nga të hyrat e bartura për 56,247€, nga donacionet për 16,032€ si dhe nga kategoria e Rezervës 1,583,537€ për financimin e 13 projekteve kapitale për vitin 2021.

Sipas të dhënave në SIMFK, shpenzimet gjatë vitit 2021 për menaxhimin e pandemisë Covid-19 ishin 194,835€. Ato janë realizuar nga programi për rimëkëmbje ekonomike dhe kanë të bëjnë me kompensimin e pagave të stafit sipas vendimeve të nivelit qendror. Ndërsa sipas shpalosjeve në PFV, komuna ka prezantuar shpenzimet për menaxhimin e pandemisë prej 287,243€, prej tyre 207,243€ kanë të bëjnë me kompensimin e pagave të stafit si dhe 80,000€ për dezinfektimin e objekteve të komunës si dhe për blerje të materialeve hixhienike për parandalimin e infeksionit.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2021



Të hyrat e realizuara nga komuna në vitin 2021 ishin 712,376€ apo rreth 10% më shumë se vitin paraprak. Të hyrat kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj. Komuna kishte edhe të hyra të arkëtuara nga institucionet tjera në emër të komunës si në vijim: gjobat në trafik 139,753€ si dhe gjobat nga gjykatat 7,335€.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Pranimet	2020 Pranimet	2019 Pranimet
Totali i të hyrave	646,165	646,165	712,376	409,922	551,628
Të hyrat tatimore	537,024	537,024	473,002	232,312	279,041
Të hyrat jo tatimore	109,141	109,141	238,124	177,610	272,587
Të hyrat tjera	0	0	1,250		

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2020 ka rezultuar në 13 rekomandime. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Mirëpo, komuna nuk ka raportuar lidhur me zbatimin e rekomandimeve përmes raporteve periodike të zbatimit të rekomandimeve të cilat ishte dashur të dorëzoheshin me 30.09.2021 dhe 31.03.2022. Përderisa, shqyrtimi i raportit të auditimit në Kuvendin Komunal ishte bërë në shkurt 2022. Deri në fund të auditimit për vitin 2021, një (1) rekomandim është zbatuar si dhe për 12 rekomandime nuk ka filluar zbatimi, siç është paraqitur më poshtë në Grafikon 2. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën e rekomandimeve nr. 4.

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për konkluzion	Kryetari i Komunës duhet të siguroj bashkëpunim dhe komunikim më të mirë në mes të Departamentit të Tatimit në Pronë Komunal dhe Ministrisë së Financave, në mënyrë që të eliminohen gabimet e mundshme në bazën për tatimin e vlerësuar, apo ndonjë gabimi tjetër eventual.	Edhe këtë vit kemi evidentuar dukurinë e njejtë.	Nuk ka filluar zbatimin
2.	Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj arritjen e verifikimit të 20% të pronave të paluajtshme në mënyrë që të integrohen të gjitha ndryshimet eventuale në bazën e të dhënave për pronat ekzistuese të komunës. Mbledhja e të hyrave nga ky burim do të ndikoj drejtpërdrejt në realizimin e projekteve që kanë efekt në rritjen e cilësisë së shërbimeve për qytetarët e komunës.	Verifikimi i 20% të pronave nuk është arritur as në vitin 2021.	Nuk ka filluar zbatimin

3.	Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj një kordinim më të mirë ndërmjet komunës dhe departamentit të tatimit në pronë në kuadër të Ministrisë së Financave, me qëllim të përmirësimit të të dhënave në bazën e të dhënave. Po ashtu, Kryetari duhet të shtoj kontrollet që të siguroj se bëhet vlerësim i saktë i tatimit në pronë për taksapaguesin dhe të sigurojë se shqyrtimi i ankesave të tatimpaguesve nga ana e komisionit përkatës dhe zyrtarëve përgjegjës bëhet brenda afateve ligjore.	Edhe këtë vit kemi evidentuar dukurinë e njejtë.	Nuk ka filluar zbatimin
4.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë aplikimin e procedurave të prokurimit për angazhimin e stafit për MSHV. Si dhe, të sigurojë se kjo formë e angazhimit aplikohet vetëm për punë specifike dhe vetëm atëherë kur kërkesat janë të arsyeshme nga njësit kërkuese.	Edhe këtë vit kemi evidentuar dukurinë e njejtë.	Nuk ka filluar zbatimin
5.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari të siguroj që të realizohen vetem shërbimet/mallrat/furnizimet apo punët që janë të parapara në kontratë.	Nuk kemi hasur në pagesa pa kontratë gjatë vitit 2021.	I zbatuar
6.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të siguroj që subvencionimi i OJQ-ve bëhet përmes thirrjes publike siç përcaktohet me rregulloren mbi Kriteret Standardet dhe Procedurat e Financimit publik të OJQ-ve. Po ashtu me rastin e ndarjes së subvencioneve të lidhë marrveshje me përfituesit për tu siguruar se mjetet shpenzohen për objektivat e përcaktuara.	Edhe këtë vit kemi evidentuar dukurinë e njejtë.	Nuk ka filluar zbatimin
7.	Investimet kapitale	Kryetari i Komunës duhet të siguroj përmirësimin e kontrolleve të brendshme lidhur me planifikimin e saktë të nevojave për punë dhe zbatimin e drejtë të kornizës ligjore të prokurimit publik. Po ashtu duhet të siguroj se projekti i filluar nuk tejkalon paramasën e përlogaritur si në sasi ashtu edhe në vlerë ashtu siç janë përcaktuar me kushtet e kontratës.	Edhe këtë vit kemi evidentuar dukurinë e njejtë.	Nuk ka filluar zbatimin
8.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj vendosjen e kontrolleve në mënyrë që shpenzimet të planifikohen dhe të klasifikohen drejtë konform kategorive të përcaktuara me planin kontabël të SIMFK-së. Nëse projektionet e buxhetuara me ligj të buxhetit nuk përkojnë me natyrën e shpenzimit dhe nevojat e Komunës, duhet të bëhet ridestinimi i mjeteve me qëllim të sigurimit të fondeve për pagesën e rregullt të shpenzimeve. Kjo duhet të reflektoj në përpjekjen për fuqizimin e kontrollit për planifikimin, pagesën, evidentimin dhe prezantimin e drejtë të shpenzimeve publike në PFV.	Edhe këtë vit kemi evidentuar dukurinë e njejtë ngase përsëri kemi evidentuar keq klasifikim të shpenzimeve.	Nuk ka filluar zbatimin

9.	Pasuritë	Kryetari duhet të siguroj funksionimin e kontrollit të brendshëm në mirëmbajtjen e regjistrave të pasurisë duke vendosur dizajn të kontrolleve në komunikimin ndërmjet zyrtarit të pasurisë në një tërësi dhe departamentit të financave në anën tjetër dhe duke funksionalizuar modulën e zhvlerësimit në sistemin e pasurisë si dhe regjistrimit të plotë të pasurive jokapitale në këtë sistem.	Edhe këtë vit kemi evidentuar dukurinë e njëjtë ngase nuk ishte bërë regjistrimi i pasurive kapitale dhe jo kapitale në regjistrat kontabël. Po ashtu nuk ishte bërë korrigjimi i çështjeve të ngritura në raportin e vitit paraprak.	Nuk ka filluar zbatimin
10.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë se puna e komisionit të inventarizimit të është kryer me përgjegjësi të plotë dhe para përfundimit të PFV për vitin 2021. Implementimi i këtij procesi duhet të reflektojë me krahasimin ndërmjet inventarizimit dhe gjendjes së pasurisë të mbajtur në regjistrat kontabël.	Nuk janë ndërmarrë veprime të nevojshme ngase edhe këtë vit kemi evidentuar dukurinë e njëjtë.	Nuk ka filluar zbatimin
11.	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të sigurojë që obligimet të planifikohen/buxhetoren dhe paguhen brenda afateve kohore ligjore me qëllim që mos të dëmtohet buxheti i komunës me kosto shtesë të përmbarimit.	Edhe këtë vit kemi evidentuar dukurinë e njëjtë.	Nuk ka filluar zbatimin
12.	Detyrimet Kontingjente	Kryetari të siguroj që detyrimet kontingjente janë prezantuar drejtë në PFV. Duhet të sigurohen të dhënat e sakta dhe të plotë mbi këto detyrime nga zyra ligjore dhe të njëjtat të përcillen në zyrën e financave si hartuese të PFV.	Edhe këtë vit kemi evidentuar se ishte bërë nënvlerësimi i detyrimeve kontingjente.	Nuk ka filluar zbatimin
13.	Auditimi i Brendshëm	Kryetari duhet të sigurojë përgatitjen e planeve të veprimit nga njësitë e audituara për adresimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm.	Edhe këtë vit kemi evidentuar dukurinë e njëjtë.	Nuk ka filluar zbatimin

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Zukë Zuka, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm



Shehrije Shala, Drejtore e Auditimit



Ylber Sadiku, Udhëheqës i ekipit



Muharrem Qyqalla, Anëtar i ekipit



Mexhit Ferati, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi



Komuna e Deçanit
Municipality of Deçan

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2021 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit


Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Deçanit, për vitin 2021 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Bashkim Ramosaj
Kryetar i Komunës

Data: 24.05.2022



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁵ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁶, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.